



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4090 prot.

Fushë-Arrëz, më 29.12.2025

VENDIM
Nr. 50, datë 26.12.2025

“PËR

DHËNIE NË PËRDORIM FONDI PYJOR PUBLIK LOTI 1 – NË EKONOMINË PYJORE KRYEZI, QAFE PLAKE – QAFE SHARI, SAKAT – LAK HITHI PËR ENERGJI TË RINOVUSHME (EOLIKE) NË NJË SIPËRFAQE PREJ; 1.4375 HA; LOTI 2 – NË EKONOMINË PYJORE BREG DRINI, MERTUR – GURI, LUMI BERISHES PËR ENERGJI TË RINOVUSHME (EOLIKE) NË NJË SIPËRFAQE PREJ 1.5625 HA; LOTI 3 – NË EKONOMINË PYJORE BREG – DRINI, IBALLE-MEZI 1&2, LUMI I BERISHES, QAFE PLAKE – QAFE SHARI PËR ENERGJI TË RINOVUSHME (EOLIKE) NË NJË SIPËRFAQE PREJ; 1.7500 HA”

Në zbatim të Ligjit nr.139/2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, të ndryshuar, neni 9, pika 1.2, shkronja “a”, neni 27, pika 5, neni 54 shkronja “e/1”, neni 55, pika 3 dhe 4 ; Ligjit nr.57/2020 “Për Pyjet” të ndryshuar ; VKM-ne nr.134 date 3.3.2021 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433 date 08.06.2016 të këshillit të ministrave “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish Komunave/Bashkive” të ndryshuar ; VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore” ; Udhëzimi nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik”, pika nr.2 , 7, 8, 9, 10 dhe 11; Urdherit të Kryetarit nr.522 date 01.10.2024 “Për përgatitjen e raportit tekniko-ekonomik me objekt; “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik; Loti 1 - Në ekonominë pyjore Kryezi, Qafe Plake – Qafe Sharri, Sakt - Lak hithi, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.4375 Ha; Loti 2 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Mertur – Guri, Lumi i Berishes, Iballe – Mezi 1&2, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha, Loti 3 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Iballe – Mezi 1&2, Lumi i Berishes, Qafe Plake – Qafe Sharri për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.7500 Ha” ; Shkresën nr.222 date 12.12.2025 “Dërgim i Raportëve Tekniko-Ekonomik me objekt; “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik; Loti 1 - Në ekonominë pyjore Kryezi, Qafe Plake – Qafe Sharri, Sakt - Lak hithi, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.4375 Ha; Loti 2 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Mertur – Guri, Lumi i Berishes, Iballe – Mezi 1&2, për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.5625 Ha, Loti 3 - Në ekonominë pyjore Breg – Drini, Iballe – Mezi 1&2, Lumi i Berishes, Qafe Plake – Qafe Sharri për energji të rinovushme (Eolike), në një sipërfaqe prej 1.7500 Ha”, **Këshilli i Bashkisë Fushë-Arrëz në mbledhjen e tij të datës 26.12.2025**, pas shqyrtimit të propozimeve të paraqitura nga Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz,

VENDOSI

1. Miratimin për dhënie në përdorim/qira me anë të konkurimit publik (ankand) të sipërfaqes së fondit pyjor publik sipas Udhëzimi nr. 1 datë 9.6.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor

publik”, pika nr.2 , 7, 8, 9, 10 dhe 11”, që i përket; **LOTI 1** - “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik; Loti 1 - Në ekonominë pyjore Kryezi në ngastrat; 38a, 42a, 45a, 50a, 81a, 101a, 103a, 110a, Qafe Plake – Qafe Sharri në ngastrat; 35c, 41b, 61a, 72b, 73b, 85a, 96a, 131a, 133a, 138a, Sakt - Lak hithi në ngastrat; 94b, 94c, në zonen kadastrale nr.3988 me nr. Pasurie; 10, 11, 36; në zonen kadastrale nr.2295 me nr. Pasurie; 1640/2, 1637/1, në zonen kadastrale nr.2686 me nr. Pasurie; 538, 542, në zonen kadastrale nr.3261 me nr. Pasurie; 519, 462/5, 518, në zonen kadastrale nr.1054 me nr. Pasurie; 318, në sipërfaqe prej 1.4375 ha për “Energji të rinovushme (Eolike)”, (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj)”, me afat përdorimi/qiraje, 10 (dhjete) vite. **LOTI 2** - “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik; Loti 2 Në ekonominë pyjore Breg - Drini në ngastrat; 24b, 40a, 41c, 42a, 49a, Mertur – Guri në ngastrat; 19a, 20a, 21a, 22a, 24a, 27a, Lumi i Berishes në ngastrat; 6a, 11a, 27a, 25b, 28a, 43a, 46a, 51, 52b, 53a, 55a, në zonen kadastrale nr.1026 me nr. Pasurie; 1010, në zonen kadastrale nr.2196 me nr. Pasurie; 450, 447, 453, 451, në zonen kadastrale nr.1300 me nr. Pasurie; 1330, 1371, në zonen kadastrale nr.2664 me nr. Pasurie; 879, 880, 974, në zonen kadastrale nr.1160 me nr. Pasurie; 943, në zonen kadastrale nr.1162 me nr. Pasurie; 986, 970, në zonen kadastrale nr.3402 me nr. Pasurie; 654, në zonen kadastrale nr.2428 me nr. Pasurie; 549 në sipërfaqe prej 1.5625 ha për “Energji të rinovushme (Eolike)”, (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj)”, me afat përdorimi/qiraje, 10 (dhjete) vite. **LOTI 3** - “Dhënie në përdorim fondi pyjor publik; Loti 3 - Në ekonominë pyjore Breg - Drini në ngastrat; 54b, 56a, 58a, 65a, 100a, 116a, 117a, 107a, 144a, 145, Iballe – Mezi 1&2 në ngastrat; 29a, 32a, 72a, 73a, 79b, Lumi i Berishes në ngastrat; 69a, 72a, 76a, 82, 87, 88, 122, Qafe Plakë – Qafe - Shari në ngastrat; 2b, 77, 85, në zonen kadastrale nr.2438 me nr. Pasurie; 549, në zonen kadastrale nr.1300 me nr. Pasurie; 1338, 1289, në zonen kadastrale nr.3027 me nr. Pasurie; 163, në zonen kadastrale nr.2692 me nr. Pasurie; 125, në zonen kadastrale nr.1976 me nr. Pasurie; 1277/5, 1339, 1349, në zonen kadastrale nr.1054 me nr. Pasurie; 270, 280, në zonen kadastrale nr.3361 me nr. Pasurie; 459, 486, 479, 459, në sipërfaqe prej 1.7500 ha për “Energji të rinovushme (Eolike)”, (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse, etj)”, me afat përdorimi/qiraje, 10 (dhjete) vite.

2. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit (ankandit) për **LOTIN 1** është; Tr - 210,000 leke/ha/vit, Ku – 176,000 leke/ha/vit, dhe për 1.4375 Ha është; 299,750 Lekë/Vit në trungishte / kullotë, e përlogaritur kjo sipas VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore”.
3. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit (ankandit) për **LOTIN 2** është; Tr - 210,000 leke/ha/vit, Cungishte – 176,000 leke/ha/vit, Sipërfaqe boshe – 143,000 leke/ha/vit, Inproduktive – 143,000 leke/ha/vit, dhe për 1.5625, Ha është; 307,125 Lekë/Vit në trungishte / cungishte / sipërfaqe boshe / inproduktive, e përlogaritur kjo sipas VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore”.
4. Çmimi dysheme i fillimit të konkurimit (ankandit) për **LOTIN 3** është; Tr - 210,000 leke/ha/vit, Cungishte – 176,000 leke/ha/vit, Shkurre - 176,000 leke/ha/vit, Sipërfaqe me

bimësi pyjore – 143,000 leke/ha/vit, Inproduktive – 143,000 leke/ha/vit dhe për 1.7500, Ha është; 329,500 Lekë/Vit në trungishte / cungishte / shkurre / sip me bimësi pyjore / inproduktive, e përlllogaritur kjo sipas VKM nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në përdorim në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore”.

5. Qëllimi i përdorimit është dhënia në përdorimi/qira të përkohshëm të sipërfaqes fond pyjor Energji të rinovushme (Eolike), (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj)”.

6. Pikët vlerësuese sipas kriterëve të konkurimit (ankandit) për subjektet që konkurojnë do të jenë:

Nr .	Lloji i Kriterit	Pesha e matur në pike e kriterit vlerësues (e shprehur në pikë)
1	Projekti teknik i veprimtarisë që do të ushtrohet, i cili përmban hartën topografike me koordinatat e sipërfaqes objekt përdorimi në variantin PDF dhe në format elektronik në shkallë 1:10 000 ku të jenë evidentuar elementet kryesore, si: kufijtë natyrorë, relievi, objektet aktuale, si dhe çdo planimetri tjetër në shkallë më të detajuar, hartuar konform kërkesave të projektit	20
2	Planbiznesi dhe investimet që do të bëhen	15
3	Planin e rehabilitimit të sipërfaqes	25
4	Nivelin e punësimit në veprimtari	5
5	Masën e qirasë për lek/ha/vit	35

7. Dokumentacioni që duhet të plotësohet nga konkurrentët për të gjithë lotet në konkurrim është:

Përsonat fizik dhe juridik që marrin pjesë në konkurrim duhet të paraqesin dokumentet e mëposhtme:

- Kërkesë së bashku me të dhënat për gjeneralitetet e tyre;
- Ekstraktin e regjistrimit në QKR për objektin e veprimtarisë;
- Projektin teknik të hartuar nga specialistë të licencuar ku janë trajtuar të gjitha elementet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë së kërkuar;
- Planbiznesin dhe investimet që do të bëhen;
- Të dhëna për kapacitet teknike, stafin, makineritë dhe pajisjet që zotëron;
- Planin e rehabilitimit të sipërfaqes dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme;
- Nivelin e punësimit në veprimtari;
- Lejen mjedisore për aktivitetin e kërkuar / Vlerësim i Ndikimit në Mjedis paraprak (VNM).
- Çmimin e qirasë së ofruar për ha/vit;
- Adresën e subjektit, telefon, email, dhe faks.

8. Kushtet e pjesëmarrjes në konkurim për të gjithë lotet janë:

- Garanci financiare të mjaftueshme për përballimin e investimeve të parashikuara në planbiznes;
- Të ketë të kontraktuar një specialist të fushës, ku në CV-në profesionale të tregohet përvoja në fushën e veprimtarisë;
- Vërtetim nga organet përkatëse shtetërore se subjekti nuk ka procese gjyqësore në ngarkim, hetim në proces, detyrime tatimore ose detyrime të tjera ndaj të tretëve.

9. Të gjithë dokumentat e kërkuara në piken 7 dhe 8 duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

10. Bashkëlidhur këtij Projekt – Vendimi është relacioni shpjegues, harta pyjore me gjurmen dhe raportet tekniko – ekonomik për lotet 1, 2 dhe 3 me ngastrat dhe n/ngastrave që propozohen të jepen në përdorim.

11. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori Juridik dhe Drejtoria e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Fushë-Arrëz.

Ky vendim u zbardh me datë **29.12.2025** dhe hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, neni 55 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

Vendimi u miratua nga Këshilli Bashkiak me:

14 vota pro

0 vota kundër

0 vota abstenim

SEKRETAR

Naze SELIMAJ

KRYETAR

Nikolin BARDHOKU

